



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 23 Prot

Tiranë, më 14.01.2022

Nr. 2125/1 Dosje

VENDIM

PËR PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT

Unë, Rigels Bejko, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "TDR GROUP" sh.p.k, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.874, të lëshuar me datë 04.02.2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.2125/1, Datë 13.04.2021 kërkesën e kreditorit Shoqëria "VEIZI CASH & CARRY" Sh.p.k me NIPT L92606806H ndaj debitorit Shoqëria "LE FISH" Sh.p.k me NIPT L82208033A në lidhje me titullin ekzekutiv Faturë Tatimore Shitje Nr. Serie 74921707, datë 08.04.2019.

Pasi u fillua procesi i ekzekutimit te detyrueshem, duke i derguar palës debitore Lajmerimin Nr.344 Prot, Date 14.04.2021 per te ekzekutuar vullnetarisht detyrimin qe permban Urdheri i Ekzekutimit Nr.874, datë 04.02.2021, ne referim te neneve 517 dhe 518 te K.Pr.Civile, është kaluar në vënie sekuestros konservative tek pasuritë e tij, pasi u konstatua se nuk u respektua afati i këtij lajmërimi.

Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative është dërguar në:

- a) Bankat Tregtare të Nivelit të Dytë, me shkresën Nr.413 Prot, Date 04.05.2021.
- b) Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB - Tiranë), me shkresën Nr.414 Prot, Date 04.05.2021.


Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOJ

Se pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "TDR Group" sh.p.k. me datë 14.01.2022, me Nr.67 Prot, është regjistruar Kërkesa e kreditorit Shoqëria "VEIZI CASH & CARRY" Sh.p.k me NIPT L92606806H ku kërkohet pushimi i ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.874, të lëshuar me datë 04.02.2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në këto kushte, referuar nenit 616, pika "b" të Kodit të Procedurës Civile dhe Ligjit Nr.26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",





VENDOSA

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.874, të lëshuar me datë 04.02.2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Urdhërohen Bankat Tregtare të Nivelit të Dytë, të zhblokohen nga masa e sekuestros konservative depozitat, kredite apo llogarite bankare të Shoqëria "LE FISH" Sh.p.k me NIPT L82208033A, bllokuar me shkresën Nr.413 Prot, Date 04.05.2021 të Zyrës së Përmbaarimit Privat "TDR Group" sh.p.k.
3. Urdhërohet Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB - Tiranë), të zhblokojë nga masa e sekuestros konservative menjehere aksionet e zotëruara nga Shoqëria "LE FISH" Sh.p.k me NIPT L82208033A, bllokuar me shkresën Nr.414 Prot, Date 04.05.2021, të Zyrës së Përmbaarimit Privat "TDR Group" sh.p.k.
4. Një kopje e vendimit të pushimit t'i dorëzohet palëve në procesin përmbaarimor.
5. Ky vendim mund të ankimohet përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, brenda 5-ditësh nga marrja dijeni.

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "TDR GROUP" sh.p.k.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

RIGELS BEJKO



Zyra e Përmbaarimit Privat "TDR Group" sh.p.k
Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr. 5 ,Kati i 11-të , Nr.54 Tiranë
Tel : 00355 42 427790
www.tdr.al